Benediktinerkloster
Mariastein

Albanisch – Shqiptare

«Nisja për në hapësirat e gjera»

«Mariastein 2025»

– është emri i projektit që filloi në manastirin benedikt Mariastein në vitin 2015. Ky projekt mbështetet te premtimi biblik, i cili flet për «Dalja në fushat e gjera» (Psalmi 18,20) dhe është i orientuar drejt së ardhmes së manastirit Mariastein:

- *Shenjtërimi i Nënës së Jezu Krishtit dhe pelegrinazhi*
- *Manastiri dhe komuniteti i tij*
- *Ndërmjetësimi i orientimit fetar dhe thellimi i besimit*
- *Propozimet në fushat e edukimit dhe kulturës shpirtërore dhe fetare, shëndetit, kohës së lirë dhe gastronomisë*
- *Përdorimi dhe menaxhimi i ndërtesave të vetë manastirit*
- *Riorganizimi i sheshit të manastirit dhe menaxhimi i parkingut në hyrje të fshatit*

Sot e gjithë përgjegjësia për manastirin dhe pelegrinazhin bie mbi 16 murgjit benediktë. Më shumë se gjysma e tyre janë mbi 80 vjeç. Rreth 25 punonjës (15 prej tyre me kohë të plotë) punojnë në zonën e brendshme të manastirit, në pelegrinazh, në shtëpinë e pritjes dhe në dyqanin e manastirit. Ferma e manastirit, hoteli i manastirit «Kreuz» dhe restoranti «Post» janë dhënë me qira.

Murgjit janë të betuar sipas urdhrit të manastirit të Shën Benediktit. Ata takohen pesë deri në gjashtë herë në ditë për lutje dhe adhurim të përbashkët. Gjithashtu, ata shërbejnë në fushat e pelegrinazhit dhe kujdesit baritor. Ata janë përgjegjës për organizimin e meshave, për revistën e manastirit «Mariastein», për arkivin dhe pasuritë kulturore, si dhe janë të përfshirë në trajnimin dhe edukimin e mëtejshëm dhe në disa organe të tjera të kishës.

Mariastein është shndërruar në një vend pelegrinazhi që në mesjetën e vonë. Zemra e shenjtores rreh në një shpellë shkëmbore (Streha e Mëshirës), ku Maria adhurohet dhe thirret si ndërmjetësuese. Rreth vitit 1640, benediktët erdhën nga komuna Bainvil SO dhe zunë vend në Mariastein. Ata ndërtuan kompleksin e manastirit dhe kishën e pelegrinazhit dhe që prej asaj kohe u shërbejnë pelegrinëve.

Në Mariastein vijnë çdo vit rreth 250'000 pelegrinë. Shumë prej tyre vizitojnë shpellën dhe kishën për të pushuar dhe reflektuar, për të gjetur qetësinë dhe rehatinë, për t'u lutur dhe për të kërkuar, për të falënderuar dhe për të lavdëruar Perëndinë. Të tjerët janë të interesuar për artin dhe kulturën; ka dhe të tjerë që duan të shijojnë bukurinë e natyrës dhe pafundësinë e peizazhit. Nuk janë të paktë ata që vijnë këtu për të kaluar disa ditë, për t'u çlodhur dhe për të rikuperuar trupin dhe shpirtin, zemrën dhe mendjen.



Mariastein duhet të mbetet një vend ku njerëzit mund të gjejnë forcë dhe siguri, ku janë të mirëpritur dhe ku mund të bëhen takime të shumta.

Kjo është arsyeja pse e ardhmja e Mariastein është kaq e rëndësishme për ne. Kush do të kujdeset për zhvillimin e mëtejshëm të vendit të pelegrinazheve në të ardhmen? Kush do t'ua lërë trashëgiminë fetare dhe kulturore të Mariastein brezave të ardhshëm? Kush është përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e duhur të ndërtesave?

Komuniteti i manastirit do të jetë në gjendje ta bëjë vetë këtë edhe për disa vite të tjera. Po më pas? A do të ndërhyjnë individët privatë? A duhet që këto detyra t'i marrin përsipër institucionet e tjera të kishës? A mund ta plotësojë publiku këtë boshllëk?

«Mariastein 2025» po kërkon përgjigje për këto pyetje.
Ky është një projekt total që përfshin disa pjesë:

- *E ardhmja e komunitetit të manastirit – Zgjerimi i sponsorizimit*
- *Zhvillimi dhe riorientimi i mëtejshëm i pelegrinazhit*
- *Bashkëpunimi në fushat e besimit fetar dhe migracionit, trajtimi në mënyrë ekologjike dhe të qëndrueshme i burimeve (si: bujqësia, turizmi, vendosja e bizneseve të reja dhe ndërmarrjeve.)*
- ***Infrastruktura:** Menaxhimi dhe rinovimi i pronave të manastirit, ridizajnimi i sheshit të manastirit dhe parkingut në hyrje të fshatit.*

Disa ekspertë të huaj kanë punuar prej disa kohësh me murgjit në grupe të ndryshme pune, për të gjetur zgjidhjet që do t'i shërbejnë komunitetit të manastirit si bazë për vendimet e tyre.

«Mariastein 2025» është një projekt që do të duhen disa vjet për t'u realizuar. Komuniteti i manastirit varet nga mbështetja aktive. Një komision patronazhi me bazë të gjerë me 34 njerëz nga të gjitha fushat e jetës publike është gati për të kështilluar projektin, siç është shoqata «Miqtë e Manastirit Mariastein» me rreth 2'500 anëtarë. Përveç kësaj, ka pelegrinë që janë të afeksionuar me vendin dhe të gjithë ata që e duan dhe vlerësojnë Mariastein dhe rrethinat e tij si një zonë argëtimi në periferi.

Për realizimin e të gjitha projekteve ne llogarisim një investim prej 25 milion franga (nga janari 2021). Paratë janë të nevojshme për oferta dhe aktivitete, për biznese të reja, për rinovimin e ndërtesave dhe për projektimin e hapësirave dhe zonave publike, për organizimin dhe ndërlidhjen.

Ju jemi shumë mirënjohës për çdo mbështetje.
Llogaria e dhurimit: (Postfinance)
CH13 0900 0000 4000 2800 9

© SRF / Oscar Alessio

Autoren: Abt Peter von Sury | Mariano Tschuor
Përkthimi: Jenny Roy-Starek
Fotografie und Gestaltung: THG Fotografie | torstengeist.com

Abati Peter von Sury:

«Ne Benediktët e Mariasteinit nuk i menaxhojmë dot më vetëm këto detyra madhështore dhe magjepsëse. Kjo mund të arrihet vetëm me ndihmën ideale dhe financiare të shumë klientëve dhe një publiku të gjerë.»

Personi i kontaktit

Mariano Tschuor
Menaxher i Projektit «Mariastein 2025»
Klosterplatz 2
CH-4115 Mariastein
mariastein2025@kloster-mariastein.ch
+ 41 79 756 63 00

Spendenkonto: (Postfinance)
CH13 0900 0000 4000 2800 9

Benediktinerkloster
Mariastein

«Nisja për në hapësirat e gjera»